

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ SEFA 03-TRANS ” sh.p.k.**

Sot, më datë 12 .11.2018, në Tiranë, Shqipëri, personat e mëposhtëm:

- **Z. Esat Sefa** me atesi Dylejman shtetas Shqiptar , lindur më 07.11.1994 ne Arren Kukes dhe banues në Tirane mbajtës i letërnjoftimit elektronik me numer personal nr. **Personal : J41107071S**, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar; vendosi të themelojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë dhe me dispozitat në vijim:

**Neni 1
Themelimi**

- 1.1 Emri i shoqërisë është “SEFA 03- TRANS” sh.p.k këtu më poshtë e quajtur “**Shoqëria**”. Shoqëria është themeluar në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 1.2 Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- 1.3 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe Statutin.

**Neni 2
Selia**

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Autostrada Tirane – Durres km 14 ,
- 2.2 Shoqëria mund të hap degë dhe zyra përfaqësimi në qytete të tjera të Republikës së Shqipërisë dhe/ose jashtë saj.

**Neni 3
Objekti**

- 3.1 Objekti i Shoqërisë do të jetë:
 - A. Import-Eksport , tregtimin e artikujve te ndryshem te te gjitha llojeve , me shumice dhe pakice si : Tregtim artikuj te ndryshem industriale .Tregtim automjeteve te cdo lloji marke e tonazhi , si dhe pjese kembimi per to . Transport mallrash te te gjitha llojeve brenda dhe jashte vendit . Germime dheu transport dhe prodhim inertesh , punime eventuale muratore e betoni. Prishje dhe punime ne toke te germuar . Ndertime civile , industriale , turistike bujqesore deri ne 5 kate . Ndertime civile , industriale , turistike , nujqesore deri ne 5 kate . Rikostruksione . Punime te mirembjatjes dhe sinjalizimit ne



rruge , ndertim mbi shtresa rrugore . Punime mbrojtje te sisitemit hidraulik, cimentime .
Perforcime themeli e punime nentoksore. Izolime mbi dhe nentoksore nga ujjat. Themele
te vecanta. Punime elektrike intalime, transport te materialeve elektrike te te gjitha
llojeve , transmator . Ndertim objektesh te ndryshme dhe cdo veprimtari qe lidhet me
fushen e ndertimit ne perputhje me legjilacionin shqiptar.

B. Çdo veprimtari tjetër e ligjshme.

Neni 4 **Kohëzgjatja**

4.1 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë të pacaktuar.

Neni 5 **Kapitali Themeltar dhe Ortakët**

- 5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100.000 (njëqind mije) **Lek.**
5.2 Kapitali i Shoqërisë zotërohet nga Ortaku i vetem i shoqërisë :

Z. Esat Sefa me atesi Dylejman shtetas Shqiptar , lindur më 07.11.1994 ne Arren Kukes dhe
banues në Tirane mbajtës i letërnjoftimit elektronik me numer personal nr. **Personal**
J41107071S, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, zotërues i 1,00 (një) kuote të
shoqërisë, me vlerë 100.000,00 (njëqind mije) /Lek, duke përfaqësuar me pjesemarrje ne 100,00 %
njëqind perqind) te kapitalit themeltar me të drejtë vote;

- 5.3 Kapitali themeltar është nënshkruar dhe shlyer plotësisht me kontribute në para nga Ortaku
me themelimin e Shoqërisë.
5.4 Përgjegjësia e Ortakut shtrihet deri në shumën e kontributit të tyre në kapitalin e Shoqërisë.

Neni 6 **Asambleja e Përgjithshme**

6.1 Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë. Vendimet e
Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me dispozitat e
këtij Statuti, janë të detyrueshme për të gjithë Ortakët, pavarësisht janë apo jo të
pranishëm në mbledhje, janë apo jo dakord me këto vendime.

Neni 7 **Administratori**

7.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë administrator/ë, i/të emëruar nga Asambleja



e Përgjithshme.

- 7.2 Administratori i parë i Shoqërisë është:
-**Z. Esat Sefa** me atesi Dylejman shtetas Shqiptar , lindur më 07.11.1994 ne Arren Kukes dhe banues në Tirane mbajtës i letërnjoftimit elektronik me numer personal nr. **Personal : J41107071S**, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar
- 7.3 Mandati i Administratorit është për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh, i rinovueshëm, dhe, nëse është rasti, vazhdon deri në vendimin e ardhshëm të Asamblesë së Përgjithshme që do të marrë vendim në lidhje me rinovimin e mandatit të tij apo emërimin e administratorit të ri.
- 7.4 Shoqëria përfaqësohet ndaj të tretëve nga Administratori i cili është përgjegjës personalisht për shkelje të ligjit dhe të Satutit dhe për gabimet e kryera gjatë administrimit të Shoqërisë.

Neni 8

Viti Financiar

- 8.1 Viti financiar fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik. Në përfundim të vitit kalendarik Administratori harton pasqyrat financiare të Shoqërisë në përputhje me ligjet në fuqi.
- 8.2 Përfundimisht, viti i parë financiar fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon më 31 Dhjetor 2018.

Neni 9

Të ndryshme

- 9.1 Ky Akt Themelimi është hartuar dhe nënshkruar në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe, me të njëjtën vlerë secila.

ORTAKU

ESAT SEFA

Esat Sefa

